



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1168/13 Prot

Tiranë, më 7/11/2016

Lënda: Jepet mendim për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10128, datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike të ndryshuar”, i ridërguar.

Drejtuar: Znj. Milena HARITO
MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN
PUBLIKE.

Tiranë

E nderuar znj. Harito,

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 5681/3 Prot, datë 30.12.2015, për të dhënë mendim mbi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10128, datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike të ndryshuar”, kërkojmë nga ana juaj rivlerësimin e sugjerimit të mëposhtëm:

Shkronja b) e pikës 2 të nenit 2 të ligjit, të riformulohet me këtë përmbajtje:

b) për çështje, që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale, të rregulluara nga ligji i posaçëm;

Ky parashikim reflekton përafrim të plotë të pikës 5 të nenit 1 të Direktivës nr. 2000/31/EC dhe nuk do të linte vend për interpretime jo të sakta ligjore.

Me realizimin e sa më sipër, projektligji vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

